

AKT THEMELUES

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ONYX HAIR LINE” SH.P.K.

Në bazë të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare e Biznesit” dhe të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me vullnet të lirë, të shprehur nënshkrimin e Aktit Themelues :

Znj.Redona Zaçe, e bija e Perlat, lindur me, 10/01/1996, banues ne Tirane me ID:J65110037R
Znj.Florina Belulaj, e bija e Bashkim, lindur me, 31/03/1987, banues ne Tirane me ID:
I75331092P

Sot date 01 /02/2023 vendosëm të krijojmë shoqërine me përgjegjesi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme:

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqëria “Onyx Hair Line” sh.p.k. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqerise tregtare private “Onyx Hair Line” sh.p.k. do të jetë : Rruga “Komuna e Parisit” Tiranë, zona kadastrale 8260, nr pasurie 6/758+5-N4, Tiranë .

Ajo mund te çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e:

1. Qender estetike per floket.

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitalithemeltar i shoqërisë tregtare private "Onyx Hair Line"sh.p.k. do të jetë 200.000 (dyqind mijë) lekë.

Znj. Redona Zaçe	100.000
Znj.Florina Belulaj	100.000

Perkatesisht

Znj. Redona Zaçe	50%
Znj.Florina Belulaj	50%

Kapitali përbëhet nga 2 kuota, secili nga ortakët ka nga 1 kuote dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me 100 000 lekë.

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë mund të ndryshohet, të shtohet apo të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar), sipas vendimit të ortakut themelues të shoqërisë. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

NENI 7

Ortakët duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e saj dhe të mos dëmtojnë interesat e personave të tjerë dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administrator I saj, Znj. Redona Zaçe , e cila është përfaqësuese ligjore e saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë I takojnë ortakëve themelues të shoqërisë.

NENI 10

Ortakët themelues kanë të drejtë të emërojnë dhe administrator të tjerë të vlerave material të shoqërisë. Kanë të drejtë të caktojnë financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 14

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare "Onyx Hair Line" sh.p.k.

Akti I themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

"Onyx Hair Line" sh.p.k

Redona Zaçe



Florina Belulaj

